UDHËZIM
Nr.74, datë 14.1.2004

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.895, DATË 12.4.2000 "PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.74, DATË 11.2.1999 “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET MBËSHTETJES SË FORMIMIT INSTITUCIONAL”"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet mbështetjes së formimit institucional”,

UDHËZOJ:

1. Pika 1 e udhëzimit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Në zbatim të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.74, datë 11.2.1999, Shërbimi Kombëtar i Punësimit plotëson me punëkërkues të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit për shfrytëzimin e kapacitetit të kurseve të ofruara nga punëdhënësit, veprimtaria e të cilëve është licencuar nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale dhe kanë të paktën 6 muaj eksperiencë në fushën e formimit profesional, kur ata garantojnë punësimin me kontratë të rregullt njëvjeçare të 20% të pjesëmarrësve në kurs.".

2. Fjalia e dytë e pikës 8 dhe nënpikat e saj riformulohen me këtë përmbajtje:

“Fushat prioritare ku zbatohet programi vendosen me urdhër të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale çdo fillim viti.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËS DHE I ÇËSHTJEVE SOCIALE
Engjëll Bejtaj